



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.____.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 202, datë 20.05.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARIT
{...}

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E
VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

Në raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë aspekt, pa diferencuar treguesit që e përbëjnë atë, parashtrohen konkluzione të integruara lidhur me aspektin e njohurive ligjore, duke u konkluduar, se: “...*Subjekti i*

POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka aftësi në analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe në arsyetim i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale dhe analizës së provave (dokumenti 1,2 dhe dosjet 1,4 dhe 5), si dhe ndalet me kujdes në dënimin penal. Tre dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e gjera të tij, ku bie në sy e drejta penale (dokumenti 1,2 dhe dosjet 1,4 e 5), masat e sigurimit (dokumenti 3), çështjet administrative penale (dosja 2) si dhe sekuestrim pasurie, bazuar në ligjin nr. 10192...(dosja 3).”.

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit, duke iu referuar përcaktimeve të nenit 425¹ të K.Pr.P, sipas formulimit të tij para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017, nuk ka qenë i kufizuar vetëm mbi shkaqet e ankimit të paraqitura nga palët por bëhej *mbi vlerësimin në tërësi të çështjes*. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar, gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. Në çështjet me natyrë civile, sikurse ka qenë në bazë të ligjit të kohës, çështja me objekt konfiskimin e pasurisë sipas ligjit Antimafia, gjykata, në bazë të nenit 16 të K.Pr.C, pavarësisht se objekti i saj përcaktohet nga kërkimet e palëve, zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj duke i bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Sa më sipër, roli i gjykatës në përcaktimin e saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së saj dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, element ky që do të

¹ Në nenin 425 të K.Pr.P, para ndryshimeve të tij me ligjin nr. 35/2017, sa i përket kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, parashikohet se :” 1. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkë të pandehurve që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim. 2. Kur apeluar është prokurori, gjykata e apelit: a) mund t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron ose lejon ligji; b) mund t’i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, t’i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar, të marrë masat e treguara në shkronjën “a”; c) mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese dhe masat e sigurimit. 3. Kur apeluar është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t’i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar.”.

përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose çështjes objekt shqyrtimi.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi përcaktimit të fakteve të çështjes, duke i paraqitur ato në mënyrë logjike, si rezultat i vlerësimit të provave të administruara në gjykim, duke referuar drejtpërdrejt në provën/provat respektive nga e cila buron fakti. Referimi i provave shoqëruar menjëherë me ekstraktimin e faktit/fakteve që rezultojnë dhe pranohen si të provuara nga përmbajtja dhe analiza e secilës provë të analizuar me vete ose në mënyrë të integruar më njëra-tjetrën, i jep qartësi paraqitjes së fakteve të çështjes. Në të gjithë vendimet burim vlerësimi, provat e referuara, prej të cilave gjyqtari përshkruan dhe analizon faktet e çështjes, i referohen provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë pasi nuk rezulton që të jenë marrë në ndonjë rast prova të reja gjatë gjykimit në apel. Në një rast kur është kërkuar rihapja e shqyrtimit gjyqësor me qëllim administrimin e provave të reja, kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata, duke argumentuar në vendim për shkaqet e refuzimit të kësaj kërkesë dhe vlerësimin si të panevojshme të provave të kërkuara nga mbrojtja e të pandehurit². Në dy çështje në të cilat gjyqtari ka qenë kundër, pjesërisht ose tërësisht me vendimin e kolegjit, ka hartuar procesverbalin përmbledhës, në referim të nenit 11, pika 5 të K.Pr.P, duke analizuar sipas rastit, vetëm ato rrethana fakti që lidhen me mendimin e ndryshëm të tij sa i përket formës së veçantë të bashkëpunimit³, mospranimit të shkakut të ankimit për uljen e masës së dënimit⁴, apo mospranimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kundërshtimin e vendimit për konfiskimin e pasurisë⁵.

Duke u nisur nga mënyra se si janë pasqyruar rrethanat e çështjes, pothuajse në të gjitha vendimet ose mendimet kundër të nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së

²Vendimi me nr. 9 datë 05.02.2015 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

³ Mendim kundër (pjesërisht) bashkëlidhur vendimit nr. 26, datë 16.03.2016.

⁴ Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 37, datë 09.04.2015.

⁵ Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë 29.09.2014.

gjakimit (gjakim civil lidhur me padinë në kuadër të zbatimit të ligjit Antimafia, gjakim penal themeli, apo kërkesë penale), faktet parashtrihen në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, të titulluar “fakti”, në shumicën e vendimeve të analizuara. Në disa vendime në të cilat pjesët e arsytimit të vendimit nuk janë identifikuar nëpërmjet titujve, referuar përmbajtjes dhe mënyrës së paraqitjes së tyre, faktet e çështjes evidentohen lehtësisht dhe janë pozicionuar sërish në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, menjëherë pas paraqitjes së konkluzionit të gjykatës lidhur me bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit. Në mendimet kundër (*pjesërisht ose tërësisht*), në varësi të shkakut për të cilin gjyqtari ka dalë në pakicë, rrethanat e faktit paraqiten në mënyrë të pjesshme, vetëm në lidhje me shkakun për të cilin gjyqtari ka qenë kundër vendimit të shumicës.

Në çështjet në të cilat gjykata e apelit ka konkluduar ndryshe nga shkalla e parë në raport me fajësinë e të pandehurit apo rolin e tij në kryerjen e veprës penale, analiza e fakteve të çështjes është tërësore, e detajuar dhe duke iu referuar çdo prove të administruar dhe vlerësuar në gjakimin në apel, përcaktimit të vlerës provuese të saj, përcaktimin e faktit konkret që rezulton i provuar nëpërmjet secilës provë, analizën e integruar të provave dhe përballjen e tyre, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve lidhur me faktin e pranuar si të provuar nga gjykata e apelit, duke evidentuar edhe shkaqet e vlerësimit të ndryshëm të saj në raport me konkluzionet e arritura nga gjykata e shkallës së parë sa i përket faktit. Në një rast gjyqtari i kushton rëndësi përcaktimit të fakteve të çështjes, duke i paraqitur ato si konkluzion të drejtpërdrejtë të përballjes dhe vlerësimit të provave në raport edhe me indicjet, të cilat analizohen për të mbështetur provën kryesore⁶, apo për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitareve ose mungesën e elementëve për cenimin e besueshmërisë së tyre⁷. Ky vlerësim i detajuar dhe tërësor i fakteve dhe provave mbi të cilat ato mbështeten, evidentohet qartë p.sh:

(i) në vendimin penal nr. 52, datë 06.05.2016, në të cilin gjyqtari i bën një vlerësim tërësisht të ndryshëm provave të administruara në gjakimin e shkallë të parë, duke i analizuar dhe vlerësuar ato me vete dhe në tërësi, në raport me njëra tjetrën, për të arritur në konkluzionin se fakti penal dhe autorësia e të pandehuri provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndryshe nga sa ka konkluduar gjykata e shkallës së parë në vendimin objekt ankimi;

(ii) në vendimin penal nr. 73, datë 29.06.2015, në të cilin gjyqtari bën një analizë tërësore të faktit penal, provave të administruara dhe vlerësuara, duke përcaktuar vlerën provuese të tyre, cilësinë dhe unitetin e indicjeve që rezultojnë nga provat, në mbështetje të një dëshmie të cilësuar si provë kryesore, duke konkluduar lidhur me provueshmërinë e faktit objekt akuze ndaj të pandehurit, në mënyrë të ndryshme nga sa është konkluduar gjatë gjakimit në shkallë të parë. Në këtë vendim gjyqtari merr në analizë çdo provë, dhe

⁶ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015.

⁷ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015, vendimi nr. 9, datë 05.02.2015.

pasi e çmon atë me vete dhe në raport me provat apo indicjet e tjera, ekstrakton prej saj faktin që kjo provë mbështet, në mbështetje të konkluzioneve të arritura lidhur me provueshmërinë e autorësisë së të pandehurit për veprën penale për të cilën procedohet; (iii) Në çështjen civile që i përket vendimit nr. 61, datë 29.09.2014, në të cilin gjyqtari ka hartuar mendimin kundër, fakti analizohet duke iu referuar barrës së provës së të paditurit për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së tij si dhe vlerësimin të ndryshëm të konkluzioneve të aktit të ekspertimit të administruar si provë në gjykim, duke i analizuar këto konkluzione të ndryshme të gjyqtarit, në raport me kriteret ligjore për konfiskimin e pasurisë si dhe parimin e barrës së provës së të paditurit, në kuadër të ligjit të posaçëm antimafia.

Në përfundim të analizës së fakteve të çështjes, gjithnjë duke integruar, cituar pjesërisht, analizuar dhe përballur provat e administruara, tërësisht apo në mënyrë të pjesshme në rastet e mendimit kundër, gjyqtari i kushton rëndësi në secilin vendim të analizuar, paraqitjes së një konkluzioni të përmbledhur lidhur me faktin penal të provuar si dhe autorësinë e të pandehurit, duke evidentuar veprimet/mosveprimet konkrete të tij për realizimin e faktit, si dhe duke veçuar elementët që tregojnë rolin e tij në rastet e veprave penale të kryera në bashkëpunim, si në rastet e bashkëpunimit të thjeshtë ashtu edhe në një rast të bashkëpunimit të posaçëm, në të cilin analiza e faktit dhe provave sa i përket këtij elementi bëhet në mendimin e pakicës të arsyetuar nga gjyqtari⁸.

Në vendimet që kanë pasur për objekt vlerësimin e kushteve procedurale të arrestimit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit personal ose shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit⁹, faktet e çështjes analizohen përsëri duke integruar provat apo aktet që tregojnë rrethanat procedurale konkrete, krahas përcaktimit të të dhënave që dëshmojnë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për efekt të caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit, në një rast¹⁰.

Në çdo vendim gjyqësor rezulton i dukshëm kujdesi i veçantë që gjyqtari tregon, për paraqitjen, analizën, përcaktimin e ligjshmërisë së marrjes dhe përcaktimin e vlerës provuese të provave, si dhe analizën e tyre në mënyrë të integruar më njëra tjetrën, duke mbështetur konkluzionet mbi faktin penal/civil objekt shqyrtimi. Gjithashtu, në çështjet penale, kryesisht ato të themelit, gjyqtari i kushton rëndësi specifike përcaktimit dhe analizës së fakteve që dëshmojnë veprimet dhe mosveprimet konkrete të të pandehurit në realizimin e faktit penal, rolin e tij në rastet e veprave të kryera në bashkëpunim, raportet e tij me viktimën e veprës penale para dhe gjatë kryerjes së veprës me qëllim përcaktimin e formës/formave të kryerjes së veprës dhe qëllimin e saj, duke i bërë në çdo rast një

⁸ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016.

⁹ Vendimi nr. 21, datë 21.04.2016 dhe vendimi nr. 54, datë 15.09.2015.

¹⁰ Vendimi nr. 21, datë 21.04.2016.

vlerësim të pavarur të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse mënyra e përcaktimit të faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi. Kjo sepse përcaktimi i saktë i faktit është vlerësuar nga gjyqtari si thelbësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 425 të K.Pr.P, si dhe lidhet në çdo rast me analizimin e shkaqeve të ankimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

-Identifikimi i natyrës së çështjes:

Nga identifikimi dhe përshkrimi i plotë dhe i qartë i fakteve, gjyqtari konkludon për natyrën e çështjes objekt shqyrtimi (*civile apo penale*). Përcaktimi i natyrës juridike të çështjes, edhe pse ky element nuk është identifikuar në mënyrë të shprehur në vendime, rezulton e qartë duke iu referuar objektit të ankimit dhe kompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda e cila shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në lidhje me çështje penale dhe çështje të ligjit antimafia, të cilat në kohën e marrjes së vendimeve burim vlerësimi, përcaktoheshin nga ligji si çështje me natyrë civile.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i qartë i natyrës së çështjes lidhet drejtpërdrejt me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e saj. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari identifikon dhe referon ligjin e zbatueshëm, duke u kufizuar në citimin e tij vetëm në një numër të kufizuar rastesh.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtari identifikon duke referuar si ligj të zbatueshëm:

(i) nenin 425, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me shqyrtimin e çështjes së ankimit në shkallë të dytë, nenin 425, paragrafi 2 lidhur me parimin procedural të mos rendimit të pozitës së të pandehurit¹¹ dhe nenin 428 të po këtij Kodit si referencë të vendimmarrjes përfundimtare të gjykatës.

(ii) nenin 152 të K.Pr.P në lidhje me përcaktimin e vërtetësisë, çmuarjen dhe vlerësimin e provave¹² dhe nenin 154 të K.Pr.P lidhur me papërdorshmërinë e provave dhe dëshminë indirekte¹³.

(iii) nenin 383/1/ç të K.Pr.P, lidhur me detyrimin e gjykatës për të dhënë arsye për vlerësimin si të papranueshme të provave të kundërta¹⁴;

(iv) nenin 356 të K.Pr.P lidhur me të drejtën e të pandehurit për të kërkuar marrjen e provave¹⁵;

¹¹ Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 26, datë 16.03.2016.

¹² Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015, vendimi nr. 26, datë 16.03.2016.

¹³ Vendimi nr.85, datë 28.07.2016.

¹⁴ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015

- (v) nenin 418 të K.Pr.P lidhur me heqjen dorë nga ankimi dhe nenin 420 të K.Pr.P sa i përket vendimmarrjes së gjykatës në rastin e heqjes dorë¹⁶;
- (vi) nenin 380 të K.Pr.P në lidhje me përcaktimin e provave mbi të cilat do të mbështetet vendimi¹⁷;
- (vii) nenin 252 të K.Pr.P lidhur me gjendjen e flagrancës dhe nenet 228,229 dhe 230 lidhur me kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal si dhe kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”¹⁸;
- (viii) nenin 227, 201, 223 të K.Pr.P sa i përket kompetencës së organeve të hetimit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe ligjshmërinë e marrjes së provave nëpërmjet mjeteve procedurale të kërkimit të tyre¹⁹;
- (ix) nenet 323 dhe 324 të K.Pr.P lidhur me vlerësimin e rasteve dhe shkaqeve për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake²⁰;

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet e analizuara, gjyqtari identifikon dispozitat e ligjit material, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal dhe bazueshmërisë së kërkimeve objekt padie, në çështjen me objekt konfiskimin e pasurisë. Konkretisht, gjyqtari identifikon nenet e Kodit Penal mbi të cilat bëhet kualifikimi ligjor i faktit/fakteve penale për të cilat procedohet, apo për të cilat akuzohen të pandehurit në çdo çështje dhe konkretisht :

- (i) neni 79/c i Kodit Penal në lidhje me veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare dhe nenin 278²¹ në lidhje me veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake²²;
- (ii) neni 283/a²³ dhe 283 i Kodit Penal lidhur me veprat penale të trafikimit të narkotikëve dhe prodhimit dhe shitjes së narkotikëve²⁴;
- (iii) neni 110/a i Kodit Penal lidhur me veprën penale të trafikimit të personave të rritur²⁵;
- (iv) neni 278/a i Kodit Penal sa i përket veprës penale të trafikimit të armëve dhe municionit²⁶;
- (v) neni 109/b i Kodit Penal lidhur me veprën penale të shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie²⁷;

¹⁵ Vendimi nr. 51, datë 06.05.2016.

¹⁶ Vendimi nr.129, datë 24.12.2015.

¹⁷ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016.

¹⁸ Vendimi nr. 24, datë 21.04.2016.

¹⁹ Vendimi nr.85, datë 28.07.2016.

²⁰ Vendimi nr. 54, datë 15.09.2015

²¹ Vendimi nr. 09, datë 05.02.2015;

²²Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015.

²³ Vendimi nr. 14, datë 29.01.2016, vendimi nr. 125, datë 07.12.2015, vendimi nr. 109, datë 18.11.2014, vendimi nr. 84, datë 20.11.2013, mendim kundër bashkëlidhur vendimi nr. 37, datë 09.04.2015,

²⁴ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016.

²⁵ Vendimi nr. 09, datë 05.02.2015.

²⁶ Vendimi nr. 89, datë 12.12.2013.

²⁷ Vendimi nr. 54, datë 15.09.2015, vendimi nr. 85, datë 28.07.2016.

Gjithashtu, gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, si:

- (i) nenin 3 të Kodit Penal lidhur me zbatimin e parimit të ligjit penal favorizues²⁸;
- (ii) nenet 12, 14, 15, 16 dhe 17 të Kodit Penal, të cilët referohen në të gjitha vendimet penale të themelit, si pjesë e një analize abstrakte lidhur me përgjegjësinë penale, moshën për përgjegjësi penale, fajin, dashjen, pakujdesinë, papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore.
- (iii) nenin 22 dhe 23 të Kodit Penal në rastet e kualifikimit ligjor të faktit penal si të mbetur në fazën e tentativës dhe përgjegjësinë penale në rastet e mbetjes së veprës në këtë fazë²⁹ ;
- (iv) nenet 47, 49, 50/a të Kodit Penal sa i përket kritereve ligjore të caktimit të llojit dhe masës së dënimit dhe përcaktimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese që merren në konsideratë në këtë aspekt,³⁰;
- (v) nenin 23 të Kodit Penal lidhur me caktimin e masës së dënimit në rastet kur vepra mbetet në fazën e tentativës³¹ dhe nenin 27 të Kodit Penal lidhur me përcaktimin e shkallës së pjesëmarrjes dhe rolin e secilit bashkëpunëtor për efekt të caktimit të masës së dënimit³² ,.
- (vi) nenet 25 dhe 28 të Kodit Penal në lidhje me bashkëpunimin, kuptimin e tij, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit të thjeshtë dhe formave të veçanta të bashkëpunimit³³;
- (vii) nenin 59 të Kodit Penal lidhur me kriteret ligjore për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit³⁴ dhe nenin 55 të Kodit Penal lidhur me bashkimin e dënimeve³⁵.

Në disa raste, gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe ligje të tjera të posaçme, lidhur me aspekte materiale apo procedurale, në mbështetje të argumenteve të tij, si më poshtë:

- (i) nenin 4 të ligjit nr. 7975/1995 lidhur me klasifikimin e lëndëve narkotike, duke referuar edhe në klasifikimin e tyre sipas konventës për Narkotikët të vitit 1961³⁶;

²⁸ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015, vendimi nr. 120, datë 07.12.2015

²⁹ Vendimi nr. 49, datë 11.06.2019, vendimi nr.115, datë 11.11.2019.

³⁰ Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 37, datë 09.04.2015, vendimi nr. 85, datë 28.07.2016, vendimi nr. 84, datë 20.11.2013

³¹ Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 37, datë 09.04.2015, vendimi nr. 84, datë 20.11.2013, vendimi nr. 109, datë 18.11.2014

³² Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016 dhe mendimi i pakicës bashkëlidhur.

³³ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016 dhe mendimi i pakicës bashkëlidhur.

³⁴ Vendimi nr. 84, datë 20.11.2013, vendimi nr. 120, datë 07.12.2015.

³⁵ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015, vendimi nr.26, datë 16.03.2016,

³⁶ Vendimi nr. 109, datë 18.11.2014, vendimi nr. 120, datë 07.12.2015, vendimi nr. 51, datë 06.05.2016

- (ii) nenet 1, 12, 29/2 të ligjit nr. 99/2013 “Për armët”, referuar në kuadër të konkluzioneve të aktit të ekspertimit tekniko-balistik lidhur me armën³⁷;
- (iii) nenin 31/8 të ligjit nr. 7331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, lidhur me përcaktimin ligjor të detyrës së Shërbimit të Provës për të përgatitur raport për të pandehurin, me kërkesë të organit procedues³⁸;

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore apo të jetë analizuar mbi mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në një rast të caktuar. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin, përshkrimin dhe analizimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim. Tipar karakteristik i gjyqtarit në paraqitjen e fakteve të çështjes, është përshkrimi i tyre në çdo rast nëpërmjet analizës së detajuar dhe integruar të provave të marra në shqyrtim, duke u veçuar dhe në disa raste cituar, vetëm pjesët esenciale të përmbajtjes së tyre të cilat lidhen drejtpërdrejt me faktin konkret. Për qëllim të përcaktimit të faktit, gjyqtari referon dhe analizon në disa raste edhe mjetin procedural të kërkimit dhe mënyrën e marrjes së provës, shoqëruar menjëherë me ekstraktimin e faktit që lidhet me një element konkret të veprës penale. Fakti penal apo civil (në gjykimet në kuadër të Ligjit Antimafia) përmbledhet në fund të analizës së mësipërme dhe pasqyron pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

³⁷ Vendimi nr. 89, datë 12.12.2013

³⁸ Vendimi nr. 84, datë 20.11.2013

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Aftësia e gjyqtarit Dhimitër{...} në drejtim të këtij treguesi është vlerësuar pa cenuar ekskluzivitetin e gjyqtarit për të interpretuar ligjin, sikundër parashtrohet në kundërshtimet e gjyqtarit, duke u bazuar vetëm në vendimet gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në pjesën e analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi. Në shumicën e dokumenteve ligjore (vendime ose mendime pakice), identifikimi i normës nuk shoqërohet me interpretimin e përgjithshëm të saj. Gjyqtari aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, pa bërë paraprakisht zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale, ose kushteve dhe kriterëve të aplikimit të një norme procedurale, pavarësisht se e shqyrton në tërësi çështjen. Vetëm në disa raste, interpretimi i ligjit në zgjidhjen e çështjes, ezauron të dy hapat e tij, atë të arsyeve se pse është kjo norma materiale ose procedurale relevante që duhet të zbatohet si dhe mënyrës se si ajo zbatohet mbi faktet e provuara. Përgjithësisht rregulli ligjor aplikohet pa u përcaktuar më parë kuptimi dhe qëllimi i tij.

Procesit të interpretimit të ligjit rezulton t'i jetë kushtuar më tepër rëndësi në lidhje me normat procedurale (në çështjet ku objekti i ankimit ka pasur çështje të këtij karakteri) dhe në normat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht :

Në vendimin nr. 21, datë 21.04.2015, gjyqtari (i) interpreton dispozitat procedurale (nenin 252 të K.Pr.P) për të dhënë kuptimin e gjendjes së flagrancës, duke evidentuar qëllimin e

dispozitës, nxjerrë si konkluzion nga raporti krahasimor mes dy situatave ekzistencës së saj; (ii) interpreton nenin 228 të K.Pr.P, për të konkluduar për mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë për personin ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit; (iii) interpreton nenet 229 dhe 230 të K.Pr.P, për të vlerësuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të caktimit të masave të sigurimit, duke evidentuar karakterin kumulativ të kushteve të përgjithshme dhe atë alternativ të kushteve të veçanta.

Në vendimin nr. 129, datë 24.12.2015, gjyqtari interpreton shkurtimisht nenin 418 të K.Pr.P, në lidhje me formën e paraqitjes së aktit të heqjes dorë të palës ankuese/të pandehurit nga ankimi, duke përcaktuar se është e drejta e palës të heqë dorë me pasojë mospranimin e ankimit sipas nenit 420 të K.Pr.P.

Në vendimin nr. 54, datë 15.09.2015, gjyqtari interpreton neni 324, pg 1 dhe 2, të K.Pr.P, lidhur me të drejtën e prokurorit për të zgjatur afatin e hetimeve, duke përcaktuar qëllimin e ligjvënësit, si dhe duke krahasuar paragrafët 1 dhe 2 të nenit, duke bërë diferencën mes tyre sa i përket nevojës për të argumentuar arsyet e zgjatjes së afatit si kërkesë e domosdoshme në rastet e zbatimit të paragrafit të dytë në raport me konkluzionin e arritur prej tij sa i përket kuptimit të paragrafit të parë të nenit 324, në zbatim të të cilit prokurori nuk ka detyrimin të përcaktojë arsye për zgjatjen e parë të afatit të hetimeve paraprake. Ky interpretim vjen në funksion të konkluzionit që gjyqtari ka arritur se ankimi i paraqitur nga prokuroria është i bazuar dhe vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë në vendimin e ankimit nuk është i bazuar.

Në vendimin nr. 51, datë 06.05.2016, gjyqtari interpreton duke dhënë në mënyrë të përmblendhur kuptimin e nenit 383, paragrafi 1, shkronja “ç” të K.Pr.P, në shërbim të konkluzionit se detyrimi i gjykatës për të dhënë arsye për provat që i vlerëson si të papranueshme, nuk aplikohet në rastet kur vetë pala (ankuesi) nuk ka pretenduar apo paraqitur prova për të mbështetur pretendimin e tij.

Në vendimin nr. 26, datë 16.03.2016 dhe mendimin e pakicës lidhur me formën e veçantë të bashkëpunimit, gjyqtari interpreton nenin 152 të K.Pr.P në drejtim të evidentimit të detyrimit të gjykatës për të vlerësuar ligjshmërinë e marrjes së provës, vërtetësinë e saj, besueshmërinë e dëshmitarëve, përcaktimin e vlerës provuese si dhe çmuarjen tërësore të provave në raport me njëra-tjetrën. Në këtë kontekst gjyqtari interpreton paragrafin e dytë të nenit 152 të K.Pr.P, në shërbim të konkluzionit të arritur mbi cilësinë e indiceve në mbështetje të argumentit për përcaktimin e besueshmërisë së dëshmitarit.

Në dokumentet e tjera të analizuara (vendime ose mendime pakice), dispozitat procedurale referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi elementët me karakter procedural.

Në vendimet penale: Vetëm në disa raste interpretimi i ligjit material, kryesisht dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, bëhet fillimisht në mënyrë të pavarur për tu aplikuar më pas mbi faktet e çështjes. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se :

(i) Për të përcaktuar përgjegjësinë penale, fajin, format fajit (dashje direkte, indirekte, pakujdesi), gjyqtari interpreton në mënyrë të zgjeruar dhe të integruar me njëri tjetrin nenet 12,17,14,15 dhe 16 të Kodit Penal, në nivel abstrakt, duke i kushtuar rëndësi konkluzionit se në rastet e dashjes direkte zbatohet parimi i prezumimit ndërsa në rastet e dashjes indirekte ose pakujdesisë, forma e fajit duhet të provohet. Ky interpretim i përgjithshëm i paraqitur në një paragraf hyrës, në pjesën e vlerësimit të gjykatës të titulluar “Faji”, gjendet në çdo vendim penal themeli³⁹. Pas këtij interpretimi, arsyetimi vijon me evidentimin e fakteve të provuara në gjykim në raport me elementët e figurës së veprës penale konkrete për të cilën procedohet dhe veprimet konkrete të të pandehurve për realizimin e saj.

(ii) Në të gjitha vendimet penale të themelit, për të mbështetur argumentimin mbi masën e dënimit, me qëllim vlerësimin e bazueshmërisë së vendimit të apeluar apo për të vlerësuar kërkimet objekt ankimi lidhur me llojin dhe masën e dënimit, gjyqtari interpreton nenin 47 të Kodit Penal, duke përcaktuar rrethanat që merren në konsideratë në caktimin e dënimit, dhe duke i aplikuar ato mbi rastin konkret, në mbështetje të vlerësimit për përshtatshmërinë e masës së dënimit të përcaktuar në vendimin e apeluar apo dënimin e caktuar nga gjykata e apelit në një rast të uljes së tij⁴⁰ si dhe në dy raste të tjera, të caktimit të dënimit për herë të parë nga gjykata e apelit⁴¹, për shkak të ndryshimit të vendimit të pafajësisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, duke deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurin.

(iii) Në mendimin e pakicës që i përket vendimit nr. 26, datë 16.03.2016, gjyqtari interpreton nenin 28 të Kodit Penal, sa i përket formave së veçanta të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, duke analizuar dhe evidentuar kushtet për ekzistencën e kësaj forme bashkëpunimi. Nëpërmjet interpretimit të dispozitës gjyqtari konkludon për ndarjen në dy grupe të kushteve të ekzistencës së formës së veçantë të bashkëpunimit, duke i cilësuar si kushte të domosdoshëm dhe kumulative ato të grupit të parë (pjesëmarrja e tre ose më shumë personave, për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale ose jo materiale) dhe kushte jo të domosdoshme ato të grupit të dytë (anëtarësia e qëndrueshme, ndarja e detyrave, organizim dhe strukturim i zhvilluar), por të tilla që diktojnë klasifikimin e formës së veçantë të bashkëpunimit sipas formave të përcaktuara në pikën 1, 2 ose 3 të nenit 28 të K. Penal.

(iv) Në vendimet nr. 84, datë 20.11.2013 dhe nr. 120, datë 07.12.2015, gjyqtari interpreton nenin 59 të Kodit Penal, në drejtim të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve ligjore që duhet të përmbushen për aplikimin e alternativës së dënimit me burgim të parashikuar nga kjo dispozitë. Në vendimin nr. 84, datë 20.11.2013 interpretimi i nenit 59 të Kodit Penal është më i zgjeruar,

³⁹ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016, vendimi nr. 85, datë 28.07.2016, vendimi nr. 51, datë 06.05.2016, vendimi nr. 120, datë 07.12.2015, vendimi nr. 109, datë 18.11.2014, vendimi nr. 9, datë 05.02.2015, vendimi nr. 84, datë 20.11.2013, vendimi nr. 37, datë 09.04.2015, vendimi nr. 73, datë 29.06.2015.

⁴⁰ Vendimi nr. 37, datë 09.04.2015.

⁴¹ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015 dhe vendimi nr. 51, datë 06.05.2016.

duke specifikuar jo vetëm kushtet për aplikimin e tij por edhe duke vlerësuar edhe nevojën për provueshmëri të tyre, me qëllim aplikimin e dënimit alternativ. Në shërbim të këtij interpretimit dhe për të mbështetur konkluzionin e arritur se në rastin konkret neni 59 i Kodit Penal nuk gjen aplikim, gjyqtari interpreton edhe nenin 31/8 të ligjit nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, duke theksuar nevojën e administrimit të raportit të shërbimit të provës, për të vlerësuar përmbushjen ose jo të kushteve ligjore në drejtim të vlerësimit të gjendjes sociale, ekonomike, familjare, etj.

Dispozitat e tjera të ligjit penal material, të identifikuar si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, nuk konstatohet që të jenë interpretuar në nivel teorik, në lidhje me veprat penale përkatëse që i atribuohen të pandehurve, (*p.sh. neni 79/c, 278/a, 278, 283/a, 110/a dhe 109/b të K. Penal*), por elementet të figurës së veprës penale, posaçërisht në raste të caktuara forma e fajit, qëllimi, kryerja e veprës në bashkëpunim, janë evidentuar drejtpërdrejtë duke vlerësuar faktet e çështjes dhe analizuar provat konkrete mbi të cilat ato mbështeten.

Në mendimin e pakicës që i përket vendimit nr. 61, datë 29.09.2014, nuk konstatohet referimi dhe as interpretimi i dispozitave ligjore, por gjyqtari është përqendruar vetëm në analizën e rezultateve të aktit të ekspertimit dhe argumentimin lidhur me vlerësimin e ndryshëm të konkluzioneve të tij sa i përket ligjshmërisë së pasurisë së të paditurit.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante:

Në tërësinë e vendimeve të analizuara, nuk rezultojnë në asnjë rast që gjyqtari të ketë identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtari, edhe pse nuk i përmend nominalisht, zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt që rezultojnë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzioni i arritur. Në këtë këndvështrim, evidentohet se gjyqtari njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë: (i) përmbushja e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve si një nga aspektet kryesore të procesit të rregullt ligjor; (ii) parimi i disponibilitetit të palëve në lidhje me të drejtën për të hequr dorë nga ankimi me pasojë mospranimin e tij⁴²; (iii) parimi i barrës së provës në gjykimin civil sipas ligjit të posaçëm⁴³; (iv) parimin procedural të mos rendimit të pozitës së të pandehurit në lidhje me masën e dënimit, kur çështja shqyrtohet në apel vetëm mbi bazën e ankimit të tij⁴⁴. Gjyqtari njeh dhe zbaton parimet e së drejtës materiale në

⁴² Vendimi nr. 129, datë 24.12.2015

⁴³ Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë 29.09.2014.

⁴⁴ Vendimi nr. 26, datë 16.03.2016 dhe mendimi i pakicës bashkëlidhur, vendimi nr. 85, datë 28.07.2016.

mbështetje të interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel si: parimi i zbatimit të ligjit penal në kohë dhe aplikimit të ligjit penal favorizues, në rastet kur dispozitat e posaçme të Kodit Penal kanë pësuar ndryshim në formulim ose marzhe dënimi nga koha e kryerjes së veprës penale në raport me kohën e marrjes së vendimit⁴⁵.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton më shumë rëndësi analizës së provave dhe jo në të njëjtën masë interpretimit të pavarur të normës. Dispozitat e pjesës së posaçme të K.Penal, zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me një interpretim paraprak të qëllimit, elementëve përbërës dhe zërthimit të tyre. I vetmi interpretim abstrakt i qëllimit të ligjit që dominon në vendimet gjyqësore është ai i kuptimit të përgjegjesisë penale dhe kundërligjshmërisë, por në shumicën e vendimeve nuk individualizohet sikundër citohet në çdo vendim, pse një normë e caktuar nga pjesa e posaçme e K.Penal thirret për zbatim për zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante, çka do ti jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 20 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Gjyqtari duhet të ketë në konsideratë se e tërë dija e tij profesionale do të ketë vlerë nëse vendimi i tij është hartuar në një gjuhë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

Aftësia e gjyqtarit Dhimtër{...} në drejtim të këtij treguesi është vlerësuar pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, sikundër parashtrohet në kundërshtimet e tij.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

⁴⁵ Vendimi nr. 73, datë 29.06.2015, vendimi nr. 89, datë 12.12.2013, vendimi nr. 26, datë 16.03.2016.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, apo mendimi i pakicës, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai përgjithësisht respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, ndonëse në ndonjë rast evidentohet fillimi i paragrafëve me kryeradhë me germë të vogël si dhe përdorimi i ndonjë fjale dialektore...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Vendimet gjyqësore dhe mendimet e pakicës të hartuara nga gjyqtari, në tërësinë e tyre karakterizohen nga konciziteti në mënyrën e paraqitjes dhe anën sasiore të argumenteve të paraqitura në arsyetimin e vendimit/mendimit kundër. Përgjithësisht dokumentet e analizuar kanë përmbajtje të qartë, përveç disa pjesëve të tyre, ku si rezultat i mënyrës së shprehjes së mendimit apo organizimit të argumenteve në fjali, mënyra e integritetit të pjesëve të provave apo dispozitave ligjore, vështirëson kuptueshmërinë e tekstit për lexuesin e zakonshëm.

Gjyqtari, përdor fjali me gjatësi mesatare por edhe fjali relativisht të gjata, me disa pjesë të nënrenditura, që vështirësojnë të kuptuarin e mendimit dhe arsyetimit si dhe qartësinë e shprehjes së tyre. Fjalitë janë në rrjedhë logjike të njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit ndjekin të njëjtën strukturë, duke u identifikuar shpesh me fjali tematike, të cilat evidentojnë përmbajtjen e paragrafit dhe natyrën e argumenteve në vijim.

Vendimet janë të organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër, sipas metodës deduktive të arsyetimit (jep konkluzionin e më pas shtjellon argumentet në mbështetje të tij) ose induktive (duke dhënë argumentet dhe konkluduar me përfundimin e arritur si rrjedhojë e tyre). Gjyqtari i ka përdorur në vendimet e analizuar të dy këto mënyra të organizimit dhe shprehjes së mendimit, duke i dhënë rëndësi, pavarësisht se cilën metodë përdor, evidentimit në një fjali apo paragraf hyrës ose përmbyllës, konkluzionit thelbësor lidhur me çështjen e trajtuar.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, fjalëve fyese apo denigruese. Në disa raste të veçuara, evidentohet përdorimi i fjalëve dialektore⁴⁶ apo shprehjeve me ngarkesë emocionale⁴⁷. Gjyqtari përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër është ai i referimit të konkluzioneve të akteve të ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në rastet e përdorimit të termave latinë, ato janë shoqëruar me dhënien e kuptimit të tyre në gjuhën shqipe, duke mos krijuar konfuzion për përdorimin apo kuptimin e tyre nga lexuesi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të koncizitetit të tyre. E njëjta rëndësi zbehet në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Në disa raste organizimi i paragrafëve të gjatë, me fjali të nënrenditura, shkëput rrjedhshmërinë dhe logjikën e shprehjes së mendimit, edhe pse ajo ekziston.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit “ vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 12 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri

⁴⁶ Si p.sh. fjala “mujtur”, e cila evidentohet të jetë përdorur në disa nga vendimet e analizuara.

⁴⁷ Si p.sh. shprehja “..me një dëshirë të shfrenuar për të fituar..”, evidentuar në vendimin nr. 84, datë 20.11.2013.

gjqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim*);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...*Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm. Në pjesën hyrëse të vendimeve subjekti evidentohet se në objekt paraqitet apeli dhe apeli kundërshtues (nëse ka), sipas rastit i prokurorit apo të pandehurit dhe data e paraqitjes së tij. Gjithashtu pjese arsyetuese “vëren” në shumicën e vendimeve fillon sipas rastit me pranimin apo kundërshtimin e apelit të paraqitur...*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtari, në hartimin e vendimeve përfundimtare, ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të standardizuar, e cila është e dukshme edhe në aspektin vizual në shumicën e vendimeve në të cilat përmbajtja e pjesës përshkuese arsyetuese është e ndarë dhe e titulluar sipas përmbajtjes.

Gjyqtari ndjek një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur gjykimit në apel, por në asnjë rast nuk evidenton në strukturën e vendimit shkaqet e ankimit. Gjyqtari referon në të gjitha vendimet detyrimin e parashikuar nga neni 425/1 i K.Pr.Penale, sipas ligjit të kohës, për shqyrtimin në tërësi të çështjes për çka apelohej, pa pasqyruar në vijim se cilat janë shkaqet e ankimit mbi të cilat është vënë në lëvizje gjykata e apelit. Duke mos u pozicionuar më vete në një pjesë të strukturës së vendimit, ato mbeten të panjohura për lexuesin, deri në pjesën e vendimit

kur analizohen si të tilla në vendim. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, data dhe ora e shqyrtimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, palët, përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, disponimi i gjykatës së shkallës së parë objekt ankimi, kërkimet përfundimtare të palëve në gjykimin në apel, por nuk pasqyrohen shkaqet e ankimit.

Pjesa përshkuese – arsyetuese, në shumicën e vendimeve, është e ndarë në disa nën pjesë, të identifikuara me tituj, sipas përmbajtjes, si p.sh. “fakti”, “veprimi/sjellja”, “lidhja shkakësore”, “faji”, “arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta”, “kundërligjshmëria”, “dënimi”, etj. Edhe në vendimet të cilat nuk përmbajnë tituj për pjesët e arsytimit (p.sh. vendimi nr. 54, datë 15.09.2015), përmbajtja është organizuar mbi të njëjtën logjikë. Pjesët e vendimit, brenda nënndarjeve janë të organizuara në paragrafë.

Në çdo rast arsyetimi organizohet duke përshkruar fillimisht rrethanat e faktit mbështetur në analizën e provave, evidentimit të lidhjes shkakësore midis veprimeve/mosveprimeve të të pandehurit dhe pasojës së shkaktuar, përgjegjësinë penale, arsyet për të cilat gjykata i vlerëson të papranueshme provat e kundërta (*në disa nga vendimet sipas natyrës së çështjes*), përcaktimin e kundërligjshmërisë së faktit që ka rezultuar i provuar duke e përjasur në formën e një konkluzioni me kualifikimin ligjor të tij dhe mbyllet nga vlerësimi mbi llojin dhe masën e dënimit, kërkimet për pezullimin e ekzekutimit të tij ose uljen e masës së dënimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Penale, për lënien e ne fuqi/ndryshimin e vendimit, shpenzimet procedurale, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural referuar neneve 383 dhe 428 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ndjek rregullat të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor dhe rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet, ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

Në mendimet e pakicës⁴⁸ (*procesverbal përmbledhës të motiveve kundërshtuese*), gjyqtari ka ndjekur një strukturë të ndryshme, të kushtëzuar nga natyra e aktit, duke parashtruar në fillim të tij qëndrimin pjesërisht ose tërësisht kundër qëndrimit të vendimit të

⁴⁸ Mendim pakice bashkëlidhur vendimit nr. 37, datë 09.04.2015, nr. 61, datë 29.09.2014 dhe nr. 26, datë 16.03.2016.

shumicës, referimin në bazën ligjore procedurale për paraqitjen e mendimit të pakicës (*referimin në nenet 112, pika 5 të K.Pr.P dhe 306, pika 3 të K.Pr.C*) dhe më pas paraqitjen e argumenteve lidhur me qëndrimin e mbajtur, duke integruar provat mbi të cilat ato mbështeten. Në fund të aktit, në mënyrë përmbledhëse, gjyqtari paraqet konkluzionin e tij lidhur me çështjen.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se metodologjia e përdorur nga gjyqtari në strukturimin e vendimit gjyqësor, edhe pse në dukje shfaqet si një formë standarde dhe e qëndrueshme e përdorur prej tij, jo gjithmonë orienton lexuesin drejt kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit, që në rastin konkret është vendim i gjykatës së apelit. Mos pasqyrimi i shkaqeve të ankimit në pjesën hyrëse apo në fillim të pjesës arsyetuese, e bën të vështirë kuptueshmërinë e qëndrimit të gjykatës më të lartë ndaj vendimit të gjykatës me të ulët dhe të shkaqeve pse vendimi është ankimuar. Lexuesi i dokumentit ligjor nuk arrin të kuptojë nëse analiza në vendimin gjyqësor është ezauruese, referuar shkaqeve të ankimit, pavarësisht vlerësimit që mund të ketë një gjykatë më e lartë për atë çështje.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 8 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁴⁹

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

⁴⁹ *Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.*

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“..Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet përgjithësisht e thjeshtë dhe e kuptueshme. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Edhe në rastet kur ka dalë pakicë ka bërë analizë ligjore dhe argumentuar votën kundër. Në dispozitivin e vendimit në rastet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht disponohet për shpenzimet procedurale. Lidhur me të drejtën e palëve për rekurs evidentohet se nuk është disponuar në dispozitivin e dokumenteve të paraqitura apo vendimet e 5 dosjeve të vëzhguara, me përjashtim të dokumentit 1 ku është shprehur për të drejtën e rekursit sipas ligjit...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në të gjitha vendimet gjyqësore të analizuara, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi arsytimit, duke analizuar në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet e çështjes, referuar analizës së integruar të provave të administruara në gjykimin në shkallë të parë. Në çështjet në të cilat gjykata e apelit ka shqyrtuar në themel çështjen, në tërësinë e saj dhe ka arritur në një konkluzion të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me themelin (*në dy vendimet në të cilat është konkluduar për fajësinë e të pandehurit në ndryshim nga konkluzioni për pafajësi i arritur nga gjykata e shkallës së parë*) analiza e fakteve të çështjes paraqitet tërësore dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë në të edhe një analizë të plotë të provave të vlerësuara si të papranueshme dhe shkaqeve pse provat janë vlerësuar të tilla.

Në lidhje me dënimin, vlerësimin e llojit dhe masës së dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative, posaçërisht në rastet kur kërkime lidhur me këto elementë kanë qenë shkak i ankimit objekt shqyrtimi, gjyqtari i ka kushtuar rëndësi analizës tërësore të kushteve ligjore për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, duke i integruar ato me rrethanat konkrete të çështjes, që mbështesin konkluzionin e arritur lidhur me përshtatshmërinë e masës së dënimit, aplikimin ose jo të alternativave të dënimit me burgim, apo kërkimin për uljen e masës së dënimit.

Në mendimet e pakicës, gjyqtari ka analizuar faktet e çështjes dhe provat, duke u kufizuar vetëm në ato fakte që kanë lidhje me shkakun për të cilin ai ka vlerësuar ndryshe nga shumica, duke integruar kuptimin e ligjit në shërbim të argumenteve të tij në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit në një rast⁵⁰, apo kriteret ligjore për uljen e masës së dënimit në një rast tjetër⁵¹. Në një rast tjetër, në të cilin gjyqtari ka qenë kundër vendimit të shumicës në tërësinë e tij, faktet e çështjes analizohen në mënyrë të përmbledhur dhe vetëm në raport me konkluzionet e aktit të ekspertimit dhe rezultatet e tij, duke parashtruar argumentet me të cilat gjyqtari kundërshton konkluzionet e aktit, por nuk rezulton të ketë integruar në arsyetim dispozita të ligjit apo të këtë dhënë kuptimin e tyre në shërbim të konkluzionit të arritur⁵².

Edhe pse analiza e detajuar e provave është pjesë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi, ajo nuk është e mjaftueshme për të gjykuar mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të gjyqtarit. Nëse ajo nuk shoqërohet me të njëjtën shkallë kujdesi me analizën se si konceptet ligjore dhe institutet lidhen midis tyre apo se si ato zbatohen në një situatë të caktuar (faktet e provuara), argumentimi logjik nuk është shterues. Në dokumentet ligjorë spikat aftësia e gjyqtarit në drejtim të analizës së provave, e cila zë peshën më të madhe të arsytimit të vendimeve, analizë që bazohet në arsye dhe logjikë. E njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejt me konkluzionin e arritur.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet e analizuara ato zënë një peshë specifike të arsytimit të vendimit gjyqësor, duke u evidentuar në një nënndarje të posaçme ose duke u integruar në atë pjesë të vendimit që lidhet me pretendimin përkatës në çështjet në të cilat zgjidhja e çështjes ka qenë tërësore, duke konkluduar ndryshe nga shkalla e parë lidhur me fajësinë apo kërkimin objekt shqyrtimi, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale, marrjen e provave, arsyet e mospranimit të kërkesës për rihapje të shqyrtimit gjyqësor⁵³, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal, llojin dhe masën e dënimit, etj.). Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në tërësi, si pjesë e veçantë e arsytimit të vendimit, pretendimet e palëve gjithnjë duket se kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit të vendimit ose mendimit të pakicës.

KONKLUZIONI

⁵⁰ *Mendim pakice, bashkëlidhur vendimit nr. 26, datë 16.03.2016.*

⁵¹ *Mendim pakice, bashkëlidhur vendimit nr. 37, datë 09.04.2015.*

⁵² *Mendim pakicë, bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë 29.09.2014.*

⁵³ *Vendimi nr. 9, datë 05.02.2015.*

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush standardet e procesit të rregullt ligjor si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin e gjyqtarit si në vendimet e themelit të analizuara, ashtu edhe në rastet e mendimeve të pakicës të hartuara prej tij. Analiza e plotë dhe e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim së bashku me mjetin e kërkimit dhe mënyrën e marrjes së tyre, me qëllim evidentimin e faktit penal, i jep cilësi analizës dhe argumentimit logjik. E njëjta shkallë aftësie nuk spikat në pjesën e arsytimit të mënyrës se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara. Ky proces i dytë i metodologjisë së të shkruarit të mendimit juridik, bazohet më shumë në deduksione logjike sesa analizë ligjore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.
Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “mbi mesatare” duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

| Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shumë mirë | 85 |

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin {...}, rezulton se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short, deri në dhënien e vendimit, ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 13 ditë (shih dosjen 2), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 1 muaj e 15 ditë (shih dosjen 1). Në tre rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 27 ditë (shih dosjen 3), 23 ditë (shih dosjen 4) dhe 1 muaj (shih dosjen 5). Nga analiza e këtyre të dhënave në raport me standardin kohor 9 muaj për çështjet penale të gjykatës së apelit për krime të rënda, sipas pikës 5, shkronja “i” të aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se çështjet janë përfunduar brenda afateve standard. Për 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në të tre rastet brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht: 8 ditë (shih dokumentin 2), 2 muaj e 7 ditë (shih dokumentin 1) dhe 2 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 3).”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi të cilat janë ato të administruara për efekt të rivlerësimit kalimtar, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues është bërë duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se ligji ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi për 1 prej tyre dhe konkretisht:

- (i) Çështja që i përket vendimit nr. 21, datë 21.06.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda me objekt “Ankim ndaj vendimit për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 13.04.2016, dhe

gjykimi ka përfunduar më datë 21.04.2016, brenda një afati 8/ditor, duke respektuar afatin ligjor 10/ditor të parashikuar nga neni 249, pika 5⁵⁴ të K.Pr.P.

Për 11 çështjet e përzgjedhura me short dhe 2 vendimet e tjera të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, referuar legjislacionit procedural në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimeve, nuk rezulton të jenë parashikuar afate ligjore shqyrtimi.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna të tjera veç çështjes së mësipërme, që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, prezumohet se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet e tjera për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit. Pikëzimi i këtij treguesi do të bëhet duke iu referuar çështjes së përshkruar më sipër si dhe mungesës së të dhënave të tjera që mund të vlerësohen në këtë drejtim në lidhje me të gjitha çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, çka sjell si pasojë prezumimin se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit, prandaj vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për çështje të shqyrtuara jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

⁵⁴ Në nenin 249, pika 5 të K.Pr.P, sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi, parashikohet se :” 5. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve”.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarit janë respektuar standardet minimale kohore të gjykimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afati ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport.⁵⁵

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 11 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi dhe 2 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së⁵⁶.

Referuar dy vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari, rezulton se:

- (i) Në çështjen penale nr. 67 regi, datë regjistrimi 22.04.2015, ndaj të pandehurit A.F akuzuar për kryerjen e verave penale të parashikuara nga nenet 79/c dhe 278 të Kodit Penal, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 22.04.2015 dhe data e përfundimit të çështjes është 29.06.2015. Duke përllogaritur kohëzgjatjen e gjykimit nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatë deri në datën e përfundimit të tij, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej **1 muaj e 7 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9/muaj** referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së, duke filluar ky standard nga data e regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.
- (ii) Në çështjen penale nr. 154 regi, datë regjistrimi 28.12.2015, ndaj të pandehurve M.D, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” të parashikuara nga nenet 283/a/2 dhe 283 të Kodit Penal; A.D akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe B.D akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, rezulton se çështja është regjistruar në gjykatën e apelit më datë 28.12.2015 dhe ka përfunduar më datë 16.03.2016. Gjykimi ka zgjatur **2 muaj e 16 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9/muaj** referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së, duke filluar ky standard nga data e regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.

Referuar 11 vendimeve të përzgjedhura me short, konstatohet se:

⁵⁵Shih konkluzionin e Raportit të KLGJ, cituar në treguesin më sipër.

⁵⁶ Në pikën 5 të Aneksit të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: .i. Gjykimet penale në gjykatën e apelit për krimet e rënda, jo më tej se 9 muaj. ...k. Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e apelit, jo më tej respektivisht se 2 dhe 4 muaj..” h. Gjykimet civile në Gjykatën e Apelit jo më tej se 6 muaj”

- (i) Në çështjen penale nr. nr. 89 regj them datë 06.06.2016 regjistrimi, ndaj të pandehurit A.K, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shtrengimi me anë të kanosjes për dhënie pasurie”, parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 85, datë 28.07.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, çështja është regjistruar në gjykatë në datë 06.06.2016 dhe me shortin e datës 13.06.2016 i është caktuar gjyqtarit {...}. Duke iu referuar datës së caktimit me short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **1 muaj e 15 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (ii) Në çështjen penale nr. 59 regj them datë 01.09.2015 regjistrimi, me kërkues A.L, me objekt “Kundërshtim i vendimit të prokurorisë për zgjatjen e afatit të hetimit”, përfunduar me vendimin nr. 54, datë 15.09.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 01.09.2015 dhe me shortin e datës 02.09.2015 i është caktuar gjyqtarit {...}. Duke iu referuar datës së caktimit me short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **13 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 2 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short⁵⁷.
- (iii) Çështja civile (antimafia) me nr. 61 regj them datë 01.09.2014 regjistrimi, me palë paditëse Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, i paditur O.T, me objekt “Konfiskim pasurie bazuar në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, përfunduar me vendimin nr. 61, datë 29.09.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Për gjykimin e kësaj çështje, duke iu referuar ligjit të posaçëm nr. 10192, datë 03.12.2009, sipas formulimit të tij në kohën e zhvillimit të gjykimit, janë zbatuar dispozitat procedurale të vetë ligjit duke u plotësuar me dispozitat e K.Pr.C⁵⁸. Në këtë kontekst, duke iu referuar dispozitave procedurale civile në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimit, konstatohet se çështja është regjistruar në gjykatë më datë 01.09.2014 dhe me shortin e datës 02.09.2014 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit/relatorit të çështjes. Nga dosja nuk rezulton që të jetë disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, por pavarësisht këtij konstatimi

⁵⁷ Referuar ligjit procedural të kohës në të cilën është gjykuar çështja, në nenin 325 të K.Pr.P nuk parashikohet afat ligjor shqyrtimi për ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë lidhur me ankimin ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit. Për këtë arsye, në këtë rast gjen zbatimin standardit minimal kohor 2/muaj, për shqyrtimin e kërkesave penale- administrative në gjykatën e apelit, sipas kriterëve matëse të Sistemit të Vlerësimit miratuar me vendimin e KLD nr. 261/2, viti 2010.

⁵⁸ Në nenin 5 pika 2 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, sipas formulimit të tij në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi, parashikohet se :” 2. Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile”.

pas caktimit me short, rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjen nëpërmjet shpalljes së njoftimeve për seancën e parë më datë 02.09.2014 duke caktuar seancën e më datë 12.09.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja është vënë në lëvizje në të njëjtën datë të caktimit me short dhe ka përfunduar **për 27 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

- (iv) Në çështjen penale me nr. 47 regj them datë 12.03.2015 regjistrimi, ndaj të pandehurit R.Xh, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 37, datë 09.04.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 12.03.2015 dhe me shortin e datës 17.03.2015 i është caktuar gjyqtarit {...}. Duke iu referuar datës së caktimit më short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **23 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (v) Në çështjen penale me nr. 137 regj them datë 21.11.2015 regjistrimi, ndaj të pandehurve A.Sh dhe K.A, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie”, parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 129, datë 24.12.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 20.11.2015 dhe me shortin e datës 24.11.2015 i është caktuar gjyqtarit {...}. Duke iu referuar datës së caktimit më short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **1 muaj, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (vi) Çështja penale me nr. 94 regjistri, datë regjistrimi 12.11.2013, e cila i përket ankimit të të pandehurit E.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i armëve dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/a/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 89, datë 12.12.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda më datë 12.11.2013 dhe me shortin e datës 14.11.2013 i është caktuar trupit gjykues të përbërë nga 5/gjyqtari ky gjyqtari {...} ka cilësinë e kryesuesit/relatorit të çështjes. Duke iu referuar datës së caktimit më short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **28 ditësh, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (vii) Çështja penale me nr. 77 regjistri, datë regjistrimi 08.10.2013, e cila i përket ankimit të të pandehurit E.Q, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 84, datë

20.11.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda më datë 08.10.2013 dhe me shortin e datës 10.10.2013 i është caktuar trupit gjykues të përbërë nga 5/gjyqtarë ky gjyqtari {...} ka cilësinë e kryesuesit/relatorit të çështjes. Duke iu referuar datës së caktimit më short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **1 muaj e 10 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.

- (viii) Çështja penale me nr. 143 regjistri, datë regjistrimi 16.12.2014 me objekt ankimin e të pandehurit G.B, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i personave të rritur” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 110/a/2 dhe 278/4 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 9, datë 05.02.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në datë 16.12.2014 dhe me shortin e datës 18.12.2014 i është caktuar gjyqtarit {...}. Duke iu referuar datës së caktimit më short të çështjes, si datë e fillimit të afatit standard dhe datës së shpalljes së vendimit, si datë e përfundimit të tij, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **1 muaj e 17 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (ix) Çështja penale me nr. 120 regjistri, datë regjistrimi 15.10.2014, me objekt ankimin e të pandehurit E.Gj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a dhe 22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 109, datë 18.11.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 15.10.2014, dhe me shortin e datës 20.10.2014 i është caktuar gjyqtarit {...}. Rezulton se gjykimi ka përfunduar për **28 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (x) Çështja penale me nr. 136 regjistri, datë regjistrimi 19.11.2015, me objekt ankimin e të pandehurit E.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 120, datë 07.12.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 19.11.2015, dhe me shortin e datës 24.11.2015 i është caktuar gjyqtarit {...}. Rezulton se gjykimi ka përfunduar për **14 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.
- (xi) Çështja penale me nr. 46 regjistri, datë regjistrimi 21.03.2016, me objekt ankimin e Prokurorisë në çështjen ndaj të pandehurit E.H, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 51, datë 06.05.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 21.03.2016, dhe

me shortin e datës 23.03.2016 i është caktuar gjyqtarit {...}. Rezulton se gjykimi ka përfunduar për **1 muaj e 13 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj** të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 13 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së duke u nisur nga data e caktimit të çështjes me short deri në datën e shpalljes së vendimit përfundimtar.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁵⁹

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*11 çështjet e marra në analizë janë çështje penale themeli, 1 çështje civile themeli dhe 1 kërkesë penale-administrative*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 37.36 ditë ose 1 muaj dhe 7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor 9/muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “penale administrative”, rezulton të jetë 13/ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor 2/muaj për gjykimin e çështjeve penale administrative në Gjykatën e Apelit.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, rezulton të jetë rreth 27 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

⁵⁹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Rendimenti i përfundimit të çështjeve si kryesues, bazuar në këto të dhëna, është 96 %”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik të rivlerësimit, referuar të dhënave të deklaruara nga gjyqtari dhe dokumentacionit bashkëlidhur formularit të deklarimit, rezulton se gjyqtari ka deklaruar se për periudhën janar 2014-dhjetor 2016 i janë caktuar 492 çështje, nga të cilat 127 si kryesues dhe ka përfunduar në këtë periudhë 481 çështje, nga të cilat 122 si kryesues, si dhe ka mbartur në vitin 2016 gjithsej 11 çështje, duke përfshirë në këtë numër edhe 3 çështjet në të cilat ai ka qenë i deleguar në gjykata të tjera. Referuar formatit të të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, ka mungesë të dhënash për numrin total të çështjeve të caktuara respektivisht për secilin vit për gjithë periudhën e rivlerësimit 13 tetor 2013 – 13 tetor 2016.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 96 % i përcaktuar në faqen 27 të Raportit, faqe 744 e dosjes së rivlerësimit. Nga ana tjetër, referuar metodologjisë edhe nëse do të ekzistonte një rritje e papritur e numrit të çështjeve të marra për shqyrtim, e tillë që mund të justifikonte rritje me një shkallë pikëzimi të rendimentit, numri i çështjeve të themelit të përfunduara nga gjyqtari për çdo vit të periudhës së vlerësimit, është më i ulët se standardi sasior i përcaktuar në vendimin Nr. 261/2 të KLD-së⁶⁰.

⁶⁰ Në pikes 3 shkronja “j” të Vendimit Nr. 261/2 të KLD-së, viti 2010, parashikohet se : “Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda 1 viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë :.....j) Gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda si relatori jo më pak se 20 gjykime çështjesh penale”.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 96 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 8 pikë, pasi ky rendiment është në masën 96 %.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata⁶¹ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “Si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari {...} i kushton rëndësi arsyetimit në

⁶¹ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nëpërmjet postës elektronike më datë 06.10.2020.

kohë të vendimeve. konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer nga 1 ditë nga shpallja (dosja 4), për 2 ditë nga shpallja (dosja 2), për 3 ditë nga shpallja (dosja 3), për 4 ditë nga shpallja (dosja 5) dhe për 15 ditë nga shpallja (dosja 1). Pra 4 vendime janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr.P, ndërsa për 1 vendim ky afat është kaluar me 10 ditë, por gjithsesi brenda afatit 30 ditor të paraqitjes së rekursit nga palët në proces...”

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i rekursit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1⁶² të K.Pr.P, në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr.35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, Kodi i Procedurës Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë⁶³ dhe nenit 476⁶⁴ të Kodit të Procedurës Civile.

Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30/ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 85, datë 28.07.2016, është dorëzuar më datë 12.08.2016 - (15 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (ii) Dosja 2, që i përket vendimit me nr.54, datë 15.09.2015 është dorëzuar më datë 17.09.2015 - (2 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iii) Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 61, datë 29.09.2014, është dorëzuar më datë 02.10.2016 - (3 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iv) Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 37, datë 09.04.2015, është dorëzuar më datë 10.04.2015 - (1 ditë). brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

⁶² Neni 35 pika 1 i K.Pr.P, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, parashikonte se :” Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë.”

⁶³ Në nenin 443 të K.Pr.C parashikohet se: “Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.”

⁶⁴ Neni 476 paragrafi i parë i K.Pr.C parashikon se: “Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.”

- (v) Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 129, datë 24.12.2015 është dorëzuar më datë 28.12.2015 - (4 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 06.10.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura pas fillimit të procedurës së vlerësimit, rezulton se:

- (i) Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 89, datë 12.12.2013, është dorëzuar më datë 16.12.2013 - (4 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (ii) Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 84, datë 20.11.2013 është dorëzuar më datë 27.11.2013 - (7 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iii) Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 9, datë 05.02.2015, është dorëzuar më datë 16.02.2015 (11 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (iv) Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 109, datë 18.11.2014 është dorëzuar më datë 18.11.2014 - (0 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (v) Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 120, datë 07.02.2015 është dorëzuar më datë 11.12.2015 - (4 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (vi) Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 51, datë 06.05.2016 është dorëzuar më datë 16.05.2016 - (10 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë *penale krime*, për 9 çështjet që i përkasin kësaj kategorie, është 6.2 ditë, ose 6 ditë; për kategorinë *penale administrative*, për 1 dosje të kësaj kategorie koha mesatare e arsyetimit është 2 ditë dhe për 1 çështje të kategorisë *civile* (çështje me objekt konfiskim pasurie sipas ligjit Antimafia) është 3 ditë.

KONKLUZIONI

Në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton së gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për arsyetimin e vendimeve në një kohë të shpejtë, në çdo rast, e matur kjo kohë rezulton më pak sa gjysma e afatit 30/ditor të parashikuar për ushtrimin e së drejtës së rekursit për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat ka të dhëna burimore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Për subjektin e rivlerësimit u përzgjedhën 5 dosje me short që i përkasin periudhës së gjykimit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. nga 5 dosjet e vëzhguara rezultojnë se 1 dosje ka përfunduar me 1 seancë (dosja 4), 1 dosje ka përfunduar me 2 seanca (dosja 2), 2 dosje kanë përfunduar me 3 seanca (dosja 3 dhe dosja 5) dhe 1 dosje ka përfunduar me 4 seanca (dosja 1). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 13 seanca të zhvilluara prej tij nga të cilat 9 prej tyre kanë qenë produktive dhe 4 seanca kanë qenë jo produktive (dosja 1,3 dhe 5). Vetëm në një rast seanca ka dështuar për mos formim të trupit gjykues, mosparaqitje e një anëtari të tij (dosja 5), në të gjitha rastet e tjera shkak për shtyrje është bërë sjellja e palëve në proces, mosparaqitja e avokatëve të zgjedhur e atyre të caktuar kryesisht. në çdo rast subjekti i rivlerësimit është kujdesur që të pandehurit të realizojnë të drejtën e mbrojtjes me avokat në procesin penal. në katër rastet e gjykimeve me më shumë se 1 seancë. ato janë caktuar brenda afatit kohor 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale.....”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezultojnë se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 prej tyre rezultojnë të jenë çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, ndërsa 1 çështje është kërkesë penale administrative. Konkretisht dosja nr. 2 (vendimi nr. 54, datë 15.09.2015) e cila takon kategorinë e kërkesës penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në katër çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Janë zhvilluar gjithsej 11 seanca nga të cilat 8 seanca produktive dhe 3 seanca joproduktive. Këto seanca janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si (i) njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht, (ii) marrje dokumentacioni si rezultat i rihapjes së shqyrtimit gjyqësor, (iii) dhënien kohë mbrojtësit për tu njohur me aktet ose për të përgatitur mbrojtjen, (iv) për tërheqjen e gjykatës për shpalljen e vendimit, për të siguruar prezencën e prokurorit. Në çdo rast, rezultojnë se seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale që lidhen me prezencën e palëve, respektimin e të drejtës së mbrojtës për të pandehurin, dhënien kohë mbrojtësit për t'u njohur me aktet dhe përgatitur mbrojtjen, shpalljen e vendimit, etj. Në asnjë rast nuk rezultojnë që shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore të jetë bërë mungesa e njoftimeve, planifikimi apo shkaqe të tjera të cilat mund të vlerësohen se përbëjnë përgjegjësi të gjyqtarit. Planifikimi i seancave gjyqësore rezultojnë të jetë bërë në respektin të afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Në 6 dosjet e vëzhguara, gjykimi ka përfunduar në 1 deri 4 seanca gjyqësore dhe konkretisht :

- (i) Në çështjen që i përket vendimit nr. 1202, datë 07.12.2015/dosja 10, gjykimi ka përfunduar me 1 seancë ;
- (ii) Në dy çështje që i përkasin vendimeve nr. 89, datë 12.12.2013/dosja 6 dhe nr. 109, datë 18.11.2014/dosja 9, gjykimi ka përfunduar për 2 seanca. Shkak për shtyrjen e seancave kanë qenë mos formimi i trupit gjykues për shkak të mungesës së një anëtari dhe për të dhënë kohë mbrojtësit të zgjedhur për të përgatitur mbrojtjen.
- (iii) Në dy çështje që i përkasin vendimeve nr. 9, datë 05.02.2015/ dosja 8 dhe nr. 51, datë 06.05.2016/dosja 11, gjykimi ka përfunduar për 3 seanca. Shkak për shtyrjen e seancave kanë qenë në një rast për mos formim të trupit gjykues, në një rast dhënia kohë mbrojtësit për të përgatitur qëndrimin me shkrim, shtyrja për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të zgjedhur shoqëruar me caktimin e avokatit kryesisht dhe në një rast shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit.
- (iv) Në një çështje, që i përket vendimit me nr. 84, datë 20.11.2013/dosja 7, gjykimi ka përfunduar për 4 seanca. Tre seanca janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së avokatëve të zgjedhur të të pandehurit dhe dhënien e kohës mbrojtësit të caktuar kryesisht për të njohur aktet. Pavarësisht shkakut procedural të shtyrjes së seancave

për ti garantuar të pandehurit prezencën e mbrojtësit, në çdo rast të shtyrjes së seancave janë pezulluar afatet e paraburgimit si dhe është proceduar me zëvendësimin e mbrojtësit të zgjedhur që nuk është paraqitur me avokat kryesisht.

Të gjitha seancat e vëzhguara përgjithësisht kanë filluar në kohë dhe janë regjistruar me sistemin audio dhe gjithashtu është dokumentuar në mënyrë të përmbledhur nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 4 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2.6 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (neni 460 të K.Pr.Civile dhe neni 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje apo dështimi i seancave gjyqësore për shkak të mungesës ose mangësive të njoftimeve. Gjyqtari në çdo rast ka marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë duke proceduar me zëvendësimin e avokatit të zgjedhur me avokat të caktuar kryesisht kur është vlerësuar i papërligjur shkak i mosparaqitjes, pezullimin e afateve të paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P kur shkak për shtyrje është bërë mungesa e papërligjur e mbrojtësit. Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mos formimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur vetëm për shkaqe procedurale të tilla si pjesëmarrja e palëve dhe përfaqësuesve të tyre, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, dhënia kohë mbrojtësve për tu njohur me dosjen apo përgatitur konkluzionet, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve⁶⁵ të

⁶⁵ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse”.

përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2.6 seanca, dhe po kështu gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara është më i vogël se 3 si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, ai vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Gjyqtari {...} është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar vetëm një rast kur gjykata ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor (dosja 1), po ashtu, në këtë aspekt duhet evidentuar se asnjë rast nuk është kthyer për rigjykim në shkallë të parë. Përsa i takon dokumentit 1, rezulton se vendimi i gjykatës së shkallës së parë i krimeve të rënda është ndryshuar nga gjykata e apelit dhe është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit dhe dënimi me burgim të përjetshëm, ndërkohë që ishte deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë/ ne dy

raste kur nga kolegji është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, subjekti i rivlerësimit ka dalë me mendim pakice(dosja 3 dhe 4).”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtarë dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Tek çështjet penale, dokumentohet kryerja e veprimeve paraprake të gjykimit në përputhje me nenin 426 të K.Pr.Penale, vënia në lëvizje është bërë nëpërmjet urdhërimit nga gjyqtarët në cilësinë e relatorit, për caktimin e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore dhe njoftimit të palëve. Në çështjen e posaçme sipas Ligjit Antimafia që i përket vendimit nr. 61, datë 29.09.2014, për shqyrtimin e së cilës në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi, zbaroheshin dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari vetëm një ditë pas caktimit me short, duke urdhëruar njoftimin me shpallje në referim të nenit 460 pg 2 dhe 3 të K.Pr.C, për seancën e caktuar më datë 12.09.2014, duke respektuar afatin minimal 10 ditor sipas nenit 460 pg 3⁶⁶ të K.Pr.C.

Në çdo rast të shtyrjes së seancave gjyqësore për shkaqe procedurale, ato janë caktuar përgjithësisht duke respektuar afatin 15 ditor sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për relatimin e shkaqeve të fillimit të gjykimit me vonesë, verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gjykatës mbi këto kërkesa duke parashtruar dhe arsyet e vendimmarrjes, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, njoftimin e mbrojtësve, pezullimin e afateve të paraburgimit.*). Drejtimi i seancës është zhvilluar në

⁶⁶*Neni 460 pg 3 i K.Pr.C, para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, parashikonte se:”3. Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve.”*

çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në disa raste në të cilat rezulton që gjyqtari në cilësinë e kryesuesit ka ndërhyrë gjatë zhvillimit të diskutimit të palëve, rezulton se kjo ka qenë për të orientuar gjykimin ose saktësuar kërkesat e palëve për të cilat gjykata do të duhej të shprehej.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqytjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjyimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryen në seancë gjyqësore. Gjithashtu në dosjet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet se përgjithësisht dokumentohet shkaku i vonësës së çeljes së seancave gjyqësore.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur ankimin, aktin e shortit, njoftimet dhe shkresat e gjykatës në rend kronologjik, kërkesat dhe diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e gjykatës dhe vendimin përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike.”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, urdhrat e zbardhur për pezullimin e afateve të paraburgimit, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesa, pretendime, konkluzione, prova*). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi në 11 dosjet e vëzhguara dokumentacioni i dosjes është i saktë, i plotë dhe i rregullt.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

| Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT | |
|---|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 98 |

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...}. Gjatë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit për të nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin {...}, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Së fundi duhet evidentuar se nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore dhe nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 151, datë 29.05.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezulton se KPK nuk ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit.

Në tërësi, për periudhën e vlerësimit 2013 - 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me integritetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm..”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“..Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, dhe me aktin nr. *** prot., datë 1.2.2018, ka konkluduar se: → deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; → ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; → nuk ka kryer fshehje të*

pasurisë; → nuk ka kryer deklarin të rremë; → subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. ...1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit;...”.

Sa i përket vlerësimit të kriterit të figurës, KPK konkludon se: *“Gjatë hetimeve paraprake, nuk ka pasur prova apo të dhëna nga burime të çfarëdo lloji, lidhur me përfshirjen e subjektit në veprimtari korruptive apo në lidhje me persona të përfshirë në krimin e organizuar.. 2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit..”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: *“Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për gjyqtarin në një nga 5 dosjet e vëzhguara ka pasur kërkesë për përjashtimin e tij dhe një anëtare tjetër të trupit gjykues nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga një trup tjetër gjykues dhe gjyqtarët kanë vazhduar gjykimin e çështjes deri në dhënien e vendimit përfundimtar (dosja 2). Nga ana tjetër në asnjë prej dokumenteve ligjore ose 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore ose pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të*

rivlerësimi. po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimi {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me konceptin e gjykatës së paanshme.”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimi;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimi (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimi (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimi për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me palët në proces ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; *“..Për gjyqtarin në një nga 5 dosjet e vëzhguara ka pasur kërkesë për përjashtimin e tij dhe një anëtare tjetër të trupit gjykues nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga një trup tjetër gjykues dhe gjyqtarët kanë vazhduar gjykimin e çështjes deri në dhënien e vendimit përfundimtar (dosja 2).”*

Nga analiza e burimeve të vlerësi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, *nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.*

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari) nuk rezultojnë të dhëna për një numër tejet të lartë të kërkesave të pranuar për përjashtim. Vetëm në një rast kërkesa e mbrojtësit të ankuesit për përjashtim të gjyqtarit, është rrëzuar nga trupa gjyqësore që e ka shqyrtuar atë duke e vlerësuar si të pa bazuar në ligj. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

| Nivelin i vlerësimit ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE | |
|--|-------|
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 100 |

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konstatohet se; ”..Në 5 dosjet e vëzhguara, në procesverbalin në firmat letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte, tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave dhe komunikimet shkresore me të tretët*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është korrekt, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Evidentohet komunikim i qartë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, për marrjen e masave lidhur me sjelljen e avokatëve duke shkaktuar shtyrje të gjykimit, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në aktet procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, nuk evidentohen të dhëna apo konkluzione.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk janë konstatuar seanca gjyqësore të dështuara nga planifikimi për shkak të subjektit të rivlerësimit...Ndonëse janë evidentuar raste që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo dështim të seancave të planifikuara, këto nuk kanë ardhur për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore...”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit {...} me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj., duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga burimet e vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Lidhur me këtë tregues, në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: *“..Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkollës së dytë që kryen, ai i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të dhëna, përsa i përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Gjithashtu, lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Sh. M, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të dhëna. ...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportin analitik të rivlerësimit si dhe formularit të vetë deklaramentit për aftësitë profesionale të dorëzuar nga gjyqtari për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarit {...} në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit vetëm në një aktivitet trajnues 2 ditor, të zhvilluar në datat 3 dhe 4 korrik 2013, aktiviteti i cili i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016⁶⁷.

Gjatë kësaj procedure vlerësimi, nga ana e gjyqtarit u paraqit vërtetimi me nr. 250 prot, datë 31.03.2021 i Shkollës së Magjistraturës. Referuar këtij vërtetimi, rezulton se gjyqtari {...}, veç angazhimit në cilësinë e ekspertit në aktivitetin trajnues të datave 3 dhe 4 korrik 2013, ka qenë pjesëmarrës dhe në dy aktivitete të tjera trajnuese si më poshtë:

- (i) Aktiviteti trajnues me temë « Tryezë diskutimi me trajnuesit/ekspertët e Programit të Trajnimit Vazhdues. Cilësia e përgatitjes, materialet e seminareve, jurisprudenca dhe aspekte të tjera formale e të përmbajtjes », zhvilluar më datë 31 janar 2013 nga Shkolla e Magjistraturës ;
- (ii) Aktiviteti trajnues me temë « Hetimi financiar dhe pastrimi i parave », zhvilluar më datë 30-31 maj 2013 nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Kolegjin Britanik të Policisë (EIPA).

Nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e gjyqtarit në trajnime dhe aktivitete profesionale, jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016. Pjesëmarrja e tij në cilësinë e lektorit në aktivitetin trajnues të datës 3 dhe 4 korrik 2013, duhet të konsiderohet si pjesëmarrje në aktivitete trajnuese për efekt të pikëzimit të këtij treguesi. Duke iu referuar nenit 55, pika 9⁶⁸ të

⁶⁷Formulari i vetë deklaramentit, pika 6, faqe 4, faqe 9 e dosjes së rivlerësimit dhe vërtetimi i Shkollës së Magjistraturës nr. 38 prot, datë 16.01.2017, faqe 65 e dosjes së rivlerësimit

⁶⁸Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 8 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti si dhe gjatë pesë viteve⁶⁹. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se *gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e*

-
- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
 - 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
 - 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”

⁶⁹ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se :” 1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.

Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Sh. M ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje.

Në shpjegimet e paraqitura nga gjyqtari nëpërmjet postës elektronike më datë 01.04.2021, gjyqtari, krahas aktivitete trajnuese të referuara në vërtetimin e Shkollës së Magjistraturës me nr. 250 prot, datë 31.03.2021, parashtrohet se: “Nga ana tjetër në lidhje me pyetjen për ‘pjesëmarrje në aktivitete trajnuese në cilësinë e lektorit/lehtësuesit/pjesëmarrësit, në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës’, po ashtu ju sqaroj se përzgjedhja e Ekspertit në këto trajnime bëhet në bazë të vlerave profesionale. Me vendimin n.1, dt.14/10/2010 të Këshillit të Botimeve Shkencore të Shkollës së Magjistraturës, përveçse është vendosur botimi i Tekstit ‘Koment mbi Kodin e Procedurës Penale’ në të cilin janë aprovuar vlerat shkencore të tij, po ashtu për shkak të këtyre vlerave jam përzgjedhur dhe Ekspert i përcjelljes së këtyre vlerave në trajnimin vazhdues. Pra, kush më mirë se vetë autori i Tekstit do të ishte më korrekt për të qenë Ekspert, për temat e trajtuara në tekstin e aprovuar nga Bordi i Botimeve Shkencore të vetë Shkollës së Magjistraturës. Dhe kjo sigurisht në ndryshim nga koha e krijimit të tij, tashmë për kohën pas miratimit të Tekstit. Për këtë duke vlerësuar se teksti në fjalë përmban jo më pak se 38 Tema ekspertize, rezulton se që nga viti 2011 deri në vitin 2019 kam asistuar – që do të thotë jam në cilësinë e lektorit – nëpërmjet tekstit në fjalë në 38 Tema Ekspertize. E përkthyer kjo dhe në cilësinë e ‘pjesëmarrësit’ në programin vazhdues, duke ditur se është llogaritur se një leksion/lektim si ekspert është e barabartë me 3 pjesëmarrje në seminar, së paku jam i tillë, pra pjesëmarrës, së paku në $38 \times 3 = 114$ seminare. E kështu për secilin vit, pjesëmarrës në seminarët e trajnimit vazhdues në jo më pak se në 12 të tillë që nga viti 2004. Përpara këtij të fundi më duhet ta kërkoj pranë Shkollës së Magjistraturës pjesëmarrjen time, që sigurisht nuk është më e ulët se vlerësimi maksimal”.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Sh.M, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë, pavarësisht se për periudhën 3 vjeçare rezulton vetëm për një aktivitet

trajnuet 2 ditor si ekspert dhe 2 aktivitete trajnuese si pjesëmarrës, të barazuara me 8 ditë trajnimi sipas Rregullores së Shkollës së Magjistraturës. Kjo pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me kontributin e pretenduar nëpërmjet botimit të librit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, gjyqtari do të vlerësohet në treguesin e “publikimeve ligjore”, pasi ky kontribut nuk përbën pjesëmarrje në aktivitet trajnuet.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsiderate frekuencën e angazhimit të gjyqtarit në aktivitete trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në SH.M dhe në trajnime të tjera profesionale”, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari referon në CV e tij, administruar në dosjen personale se është angazhuar në cilësinë e trajnerit në Shkollën e Magjistraturës, por nuk ka referuar të dhëna për kohën e fluksin e angazhimit të tij, për të vlerësuar nëse ky angazhim i përket periudhës së vlerësimit dhe më pas për të bërë pikësimin e këtij treguesi në bazë të të dhënave.

Nga tërësia e dokumentacionit të dosjes së rivlerësimit rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në Programin e Formimit Vazhdues të Sh. M, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, në një aktivitet trajnues dy ditor të zhvilluar në datat 3 dhe 4 korrik 2013⁷⁰, në aktivitetin me temë “Pavlefshmëria dhe papërdorshmëria”, për të cilin është paraqitur bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit edhe punimi me temën përkatëse, referuar nga gjyqtari se është paraqitur në kuadrin e ekspertizës së dhënë në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës në aktivitetin e datave 3 dhe 4 korrik 2013.

Sa i përket angazhimit të gjyqtarit në cilësinë e udhëheqësit të kandidatëve për magjistratë gjatë stazhit profesional, referuar shkresës me nr. *s'ka*, datë 23.03.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, rezulton se në vitin 2015, pranë gjyqtarit {...} ka kryer praktikën mësimore një kandidat për magjistrat, për periudhën 25 mars deri në 3 prill 2015.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit në të cilën përcaktohet se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për disponueshmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për magjistratë në kohën e kryerjes së stazhit profesional, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

⁷⁰Duke iu referuar përmbajtjes së formularit të vetë deklarimit, në pikën 6, faqe 4 e formularit, faqe 9 dhe vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës nr. 38 prot, datë 16.01.2017, faqe 65 e dosjes së rivlerësimit.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në formularin e vetë deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk janë referuar të dhëna për angazhimin e tij në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, etj.

Nga burimet e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrje të gjyqtarit në aktivitete ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata të cila ti përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, duke qene se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Lidhur me kontributin e pretenduar nëpërmjet botimit të librit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, gjyqtari do të vlerësohet në treguesin e “publikimeve ligjore”, pasi ky kontribut nuk përbën angazhim në veprimtari ndër-institucionale.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Nga ana tjetër gjyqtari ka dëshmuar se është autor i librit/tekstit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale” (pjesa e parë), miratuar botimi me vendimin nr.1, datë 14.10.2010 nga Këshilli i Botimeve Shkencore i Sh. M; autor i punimit “ekzekutimi”, paraqitur në kuadrin e ekspertizës së dhënë në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në Sh. M më datë 03.02.2012; autor i punimit “Pavlefshmëria dhe papërdorshmëria”, paraqitur në kuadrin e ekspertizës së dhënë në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në Sh. M më datë 03-04.07.2013; autor i librit/tekstit “Komentar i Kodit të Procedurës Penale”(pjesa e dytë) miratuar botimi me vendimin e datës 03.03.2016 nga Bordi i Redaktorëve i Sh. M, në procedurë botimi nga janari i vitit 2015...”(referohen edhe disa botime të përkthyer nga gjyqtari të cilat nuk kanë datë botimi);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.

Sipas formularit të vetë deklarimit⁷¹ për aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit (2013-2016), gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës si më poshtë:

- Botimin e tekstit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, Pjesa II, Bordi i redaktorëve pranë Sh. M, ka marrë vendim për botimin e këtij libri, sipas vërtetimit me nr. 29 prot, datë 13.01.2017 lëshuar nga Sh. M. Për këtë botim, sipas certifikatës së regjistrimit të të drejtës së autorit, lëshuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, me datë 30.12.2014, rezulton se z. {...} ka regjistruar të drejtat e autorit me nr. 143 RDA, për kategorinë e veprave “Krijime shkencore”. Sipas shpjegimeve të dhëna nga gjyqtari nëpërmjet postës elektronike me datë

⁷¹Formulari i vetë deklarimit, faqe 4 si dhe kopje e publikimeve bashkëlidhur formularit.

01.04.2021, saktësohet se ky punim është botuar me ISBN 988-9956-26-93-8, me volum 766 faqe.

- Lidhur me botime të tjera, gjyqtari në shpjegimet e tij ka saktësuar kohën e kryerjes së punës për tekstin më titull “Koment mbi Procedurën Penale”, duke iu referuar viteve 2004-2010 dhe 2019, vit në të cilin është botuar teksti “Koment mbi procedurën penale”, me ISBN 978-9928-2008-78. Për kohën e punimit të këtij teksti, gjyqtari parashtron se ajo është shtrirë në vitet 2011-2019. Ky botim, duke qenë se i përket vitit 2019, do të konsiderohet në vlerësimin e këtij treguesi në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin 2019.

- Në shpjegimet e tij me shkrim gjyqtari referon se në vitin 2016 ka botuar veprën e prejardhur, përkthim, me titull “Teoria e Përgjithshme e së Drejtës dhe Shtetit” ndërsa nëpërmjet kontratës me datë 22.02.2016, me nr. 37 prot, të botuesit “UET”, shpk dhe z.{...} si autor, ka shitur të drejtën për veprat e prejardhura (përkthime) me titull “Folosofia sel Diritto” dhe “Lineamenti di dottrina pura del diritto”.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016 gjyqtari ka botuar punimin shkencor me titull “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, Pjesa II, me ISBN 988-9956-26-93-8, me volum 766 faqe.

KONKLUZIONI

Pavarësisht se është vetëm një botim, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, tipologjisë dhe impaktit të botimit shkencor, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak ai pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

| Niveli i vlerësimit | |
|--|-------|
| AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL | |
| Niveli i vlerësimit | Pikët |
| Shkëlqyeshëm | 98 |

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

| Niveli i vlerësimit për çdo kriter | | |
|--|--------------|----------------------------|
| Kriteri | Pikët | Niveli i vlerësimit |
| 1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit | 85 | Shumë mirë |
| 2. Aftësitë organizative të gjyqtarit | 98 | Shkëlqyeshëm |
| 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale | 100 | Shkëlqyeshëm |
| 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional | 98 | Shkëlqyeshëm |
| Niveli i përgjithshëm i vlerësimit | | |
| Vlerësimi i përgjithshëm | 381 | Shumë mirë |